



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2022:084305
Datë: 05.08.2024
Numri i dokumentit: 06018841

K.DH.Shk II.nr.746/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.SH. “Viva Print”, me NUI:810265604, me seli në Gjilan, rruga “Marije Shllaku”, kundër debitorit N.T.SH. “EkoInvest”, me NUI:810906620, me seli në Prishtinë, rruga “Agim Ramadani”, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Avokat Hajzer Salihu nga Prishtina me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1872/22 të datës 29.11.2023, me datë **05.08.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit N.SH. “Viva Print”, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1872/22 të datës 29.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1872/22 të datës 29.11.2023, në dispozitivin e aktvendimit e ka pranuar prapësimin e debitorit N.T.SH. “EkoInvest”, duke anuluar Urdhrin Përmbartimor P.nr.208/22 të datës 26.01.2022 i Përmbartuesit Privat dhe është përfunduar në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i

Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1872/22 të datës 29.11.2023, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Debitori ka ushtruar përgjigje në ankesë nëpërmjet të cilës nga gjykata e shkallës së dytë ka kërkuar që ankesa e palës kreditore të refuzohet në tërësi si e pabazuar dhe të vërtetohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1872/22 të datës 29.11.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- **Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori N.SH. “Viva Print”, ka paraqitur propozimin për në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht faturës nr.05/2020 e datës 22.01.2020 me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që t’i paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës shumë prej 9,570.00 €, me kamatë prej 8% nga data e lejimit deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet për përpilimin e propozimit të përmbartimit si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore nën kërcënimin të përmbartimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore. Ndërsa nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare, përmbartuesi privat të zbatoj përmbartimin përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin duke theksuar se dokumenti e besueshëm në bazë të cilit është lëshuar urdhri përmbartimor nuk paraqet titull ekzekutiv pasi që i njëjti nuk përmban as nënshkrimin e as vulën e debitorit, respektivisht është lëshuar në mënyrë të njëanshme prandaj nuk është i përshtatshëm për përmbartim. Tutje ka theksuar se fatura e bashkëngjitur në propozim është kopje e cila nuk është e vërtetuar nga noteri. Duke u bazuar në të lartcekurat i ka propozuar Gjykatës ta aprovoj prapësimin si të bazuar, urdhri përmbartimor të shfuqizohet si dhe ta obligoj debitorin t’i bartë të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kreditori brenda afatit ligjor nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1872/22 të datës 29.11.2023, ku në dispozitivin e aktvendimit e ka pranuar prapësimin e debitorit N.T.SH. “EkoInvest”, duke anuluar Urdhrin Përmbartimor P.nr.208/22 të datës 26.01.2022 i Përmbartuesit Privat dhe është përfunduar në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka vlerësuar se dokumenti – fatura nr.05/2020 e datës 22.01.2020 në bazë të cilës është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban nënshkrimin apo vulën e pranuesit - debitorit dhe nuk ka dëshmi se e njëjta është pranuar nga debitori në ndonjë formë tjetër.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të faturës se lëshuar nga kreditori, e cila faturë nuk përmban elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshme për përmbarim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar”*.

Gjykata e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim ne pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës e dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata e shkalles e dytë bazuar ne Udhëzimin administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili ne nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh qe *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”*, konsideron se fatura nr.05/2020 e datës 22.01.2020, dokument ne sajë te cilës kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, nuk ka prova se është pranuar nga debitori, njëjta nuk është e vulosur e as nënshkruar nga debitori, andaj, në këtë mënyrë fatura nuk mund konsiderohet si dokument i besueshëm.

Gjykata vlerësoi pretendimet e kreditorit ne ankesë kur ka theksuar se debitori një pjesë të borxhit në shumën prej 1500€ e ka paguar duke ofruar si provë komunikimin zyrtar të debitorit, mirëpo nga komunikimi në fjalë gjykata nuk ka mundur të konstatoj se për cilën borxh është fjalë, madje pagesa e kërkuar nuk i është referuar faturës kontestuese, andaj meç debitori pretendimet e tij nuk ka arrit ti argumentoj me prova juridikisht te vlefshme ashtu siç kërkon neni 69.4 i LPP gjykata e shkallës së dytë vendosi që aktvendimin e ankimuar ta vërtetoj.

Përndryshe në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet

ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e shkallës së dytë
K.DH.Shk II.nr.746/24 me datë 05.08.2024

Gjyqtari,
Faton Bajrami